

Bashkia Rrëshen

Hyrje dhe harta e Shqipërisë, e Mirditës dhe e Bashkisë.

Hyrje

Përmbajtja

- **Pozita gjeografike**
- **Bashkia Rrëshen, oaz i begatë me resurse natyrore.**
- **Historiku**
- **Klima**
- **Burimet natyrore**
- **Demografia**
- **ETJ**

I.Pozita Gjeografike

Bashkia Rrëshen, me qendër administrative Qytetin Rrëshen, me sipërfaqe territori 14.000 ha, shtrihet:

Në veri: Mes rrjedhjes së mesme të lumit Fani i Madh dhe të Fanit të Vogël

Në jug: Kulmja e Dervenit, Pragu i Prosekut

Në lindje-juglindje: Laku i Shkallgjanës, Pragu i Prosekut

Në perendim: Pragu i Livadhësit, mali i Dervenit

Rrethi i Mirditës gjendet në zonën veriqendrore të Shqipërisë, kufizuar nga veriu me Pukën dhe Kukësin, veri-lindje me Kukësin dhe Dibrën, jug-lindje me Matin e Kurbinin dhe nga perendimi me Lezhën. Ka një sipërfaqe prej 86.700 ha, popullsi rreth 38.010 banorë.

Qyteti i Rrëshenit, si pjesë administrative e Rrethit Mirditë dhe Qarkut Lezhë, shtrihet në këto koordinata gjeografike: 19°52'45" gjatësi gjeografike lindore dhe 41°46'15" gjërësi gjeografike veriore. Brenda kësaj shtrirjeje, qyteti zë një sipërfaqe prej 65 ha dhe ka një lartësi prej 86 metra mbi nivelin e detit (sheshi i Qytetit).

II.Bashkia Rrëshen, oaz i begatë me resurse natyrore

Mirdita njihet si porta natyrore hyrëse në Shqipërinë e Epërme, ku natyrshëm konvergojnë rrugët e rretheve veriore dhe veri-lindore, në luginën e Matit dhe të Fanit. Ajo paraqet zgjidhjet më të mira për kalimin e rrugëve në veri si dhe në verilindje të Shqipërisë, atij të Ballkanit, si dhe më tutje. Ka përfunduar **rruga autostradale**, që lidh Kosovën me daljen në bregdetin Adriatik, segmenti më i rëndësishëm i së cilës kalon nëpër Mirditë me një gjatësi prej 80 km, veper, që do të japë një zhvillim të madh kësaj zone. E këtij niveli rëndësie, do të jete një lidhje autostradale, që natyrshëm kalon nëpër Rrëshen edhe që shkon në lindje dhe del në Shkup të Maqedonisë e cila fillon pas pak ditësh, si një nga zgjidhjet më oportune të mundshme.

E të njëjtës rëndësi është edhe rruga turistike Rrëshen ó Lurë, për gjallërimin e ekonomisë vendore, si dhe zhvillimit të turizmit malor, kulturor, të sporteve dimërore, të zonës turistike Kurbnesh ó Lurë, e cila është nga Tirana jo më shumë se 90 km, në kushtet e infrastrukturës bashkëkohore.

Të tria këto akse rrugore rrisin aksesin e një zhvillimi të gjithanshëm të ekonomisë së Mirditës, pasi kalojnë, njëra në veri, e dyta në qendër, dhe tjetra në jug të këtij rrethi, si dhe të Bashkisë Rrëshen, e cila bëhet një qendër me një zhvillim të përsheptuar ekonomik. Më shumë interes do të jetë lidhja e menduar e Rrëshenit me Ulzën, një basen ujor me vetem 12km nga qyteti i Rrëshenit, si dhe vete Rrësheni ka plazhet e adriatikut vetem 30-40 km. Bashkia Rrëshen disponon një fond të konsiderueshëm vreshtash me një sipërfaqe prej 100 ha nëse ajo do të subvencionohet dhe financohet me fonde për një **vreshtarie moderne** për prodhimin e rrushit si dhe të nënprodukteve të tij dhe kryesisht për prodhimin e verërave superiore të cilësisë së lartë, përben një resurs tjetër, pasi Mirdita ndodhet në një zonë tipike vreshtarie, me kushte klimatike-tokësore shumë të përshtatshme, me mundësi për ujtitje gjate gjithë ciklit të vegjetacionit e me rrjedhje të lirë, me mundësi lehtësuese për

infrastrukturën rrugore, me një traditë të kahershme në kultivimin dhe në prodhimin e verërave. Vreshtaria paraqet veprimtarinë prodhuese më kompetitive, me një treg të sigurt dhe mjaft atraktiv për vendin, rajonin si dhe më gjërë, atëhere, kur përpunimi të bëhet me teknologji perendimore. Bashkia Rrëshen ofron mundësi të zhvillojë një vreshtari me një sipërfaqe mbi 1900 ha tokë, ndërsa si rreth arrihet deri 6 000 ha. Zona malore mbi lartësinë e kultivimit të hardhisë, përdoret efektshëm për kultivimin e pemtarisë intensive (sidomos të molltove mbi nënshartesa xhuxhe), si dhe të zhvillimit të një bujqësie biologjike, apo vreshtari për prodhimin e verërave të bardha të shkumzuara.

Të nivelit ÷bio÷, sigurohet edhe **prodhimi i produkteve blegtorale** pasi rrethi i Mirditës dhe Bashkia Rrëshen, (meqë kjo bashki përbën rreth 1/3 e sipërfaqes së tokës dhe 1/2 e popullsisë të rrethit), kanë një sipërfaqe të madhe të kullotave alpine, bazë e mirë për prodhime shumë cilësore blegtorale. Tendence është zhvillimi i blegtorisë së imët dhe sidomos të dhirtave, pasi prodhimi i mishit, qumështit dhe sidomos të djathrave, përbëjnë një tendencë të re të ushqyerit të popullsisë dhe kërkesave të tregut preferencial, prodhimet e të cilave janë të kërkuara edhe nga tregu kosovar.

Interesante është edhe tendenca tjetër e re e **shtimit të bletarisë**, ku numri i koshereve të bletëve është dyfishuar brenda këtyre dy ÷tre viteve të fundit. Dhe jo vetëm shtimi numerik i bletëve, por më e rëndësishmja rritja e nivelit profesional për mbarështimin e bletarisë. Jo rrallë tek ne merret mbi 40 kg/zgjuar mjaltë.

Prirje në rritje vihen re edhe në ngritjen e **komplekseve të rritjes dhe mbarështimit të shpendtarisë, si dhe të rritjes së derrit**. Këto janë dy aktivitete ekonomike me një konsum të madh dhe tradicional të popullsisë së rrethit të Mirditës.

Për Bashkinë Rrëshen me leverdi të larte ekonomike mbetet rritja dhe mbarështimi i pyjeve dhe nënprodukteve të tij, ku sipërfaqja e pyjeve në bashki është 6 herë më e madhe se e tokës së punuar bujqësore, si dhe në rrethin tonë, është mbi 9 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore. Vitet e fundit vihet re **zhvillim i mbarë i pylltarisë** si dhe mbrojtja e tyre. Me pyjet do të jenë të lidhura shumë probleme ekologjike, si dhe prodhimet pyjorë, përpunimi i frutave të pyllit për prodhimin e lengjeve vitaminor që përben elisirin e pijeve bashkohore, si dhe zhvillimin e gjuetisë sportive etj.

Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i **kapaciteteve hidriko – energjitike të lumenjve** të Fanit të madh dhe Fanit të vogël, Urakës, zallit të Dodajve, dhe përrrenjëve të tjerë malorë, ku përlllogaritjet përafërsuese shkojnë mbi 20- 60 MW./H. Mbi lumin Fani i Madh dhe mbi lumin Fani i Vogël ka disa projekte dhe interesohen firma hidrikoenergjitike privat, për të ndërtuar basenin ujëmbledhëse për hidrocentrale të nivelit 20 MW/H. Këto burime hidrike mund të shfrytëzohen mjaft mirë për prodhime të faunës ujore (iktinologjike), si burime financiare me nivel të lartë të leverdisë ekonomike. Këto basene të mëdha ujore do të rregullonin edhe luhatjet ekstreme të temperaturave dhe të lagështisë ajrore të Rrëshenit dhe zonës për rreth.

Bashkia Rrëshen, ka një potencial të konsiderueshëm të specialistëve me arsim të lartë dhe kurse profesionale për përgatitjen e punonjësve të kualifikuar në specialitetet si hidraulik, elektrikist, rrobaqeps, mekanik, etj. si dhe forca të lira pune.

Këto dhe të tjera përparësi, që nesër do të nxjerre rrjedha ekonomike e ekonomisë së tregut të lirë, janë të dukshme për një perspektive zhvillimi të Bashkisë Rrëshen dhe njëherazi të rrethit të Mirditës.

Disa resurse të tjera natyrore:

Materiale jo metalore të fshatit Gëziq dhe Urës së Fanit, Cekaj (bazalte), që mund të përdoren për shtrim rruge e aeroporte (**materiale shkëmbinj vullkanogjen**), burime që ndodhen respektivisht 15 km dhe 3 km nga qendra e qytetit Rrëshen.

Argjila për prodhim tjegullash e tullash, burim që ndodhet në Jezull dhe Prosek, respektivisht 1.3 km dhe 4 km nga Rrësheni.

Vendburim **bakri**, me 0.9 % Cu, i ndodhur në Derven, në një sasi prej 1.156.000 ton.

Vendburim **pirotine**, me përmbajtje kalkopiriti 5-7 % bakër, i ndodhur në Cekaj.

III. Historiku

Gjurmët e banimit në trevën e Mirditës datohen që nga periudha e Neolitit dhe në vazhdim deri në ditët tona. Duke u bazuar në gjetjet arkeologjike, si ato të luginës së Matit, në tumat ilire në kodrat e

Përlatit e në mjaft pika të tjera të territorit të Mirditës, si dhe në të dhënat etnologjike, dëshmohej qartë origjina ilire e banorëve të Mirditës.

Në territorin e Mirditës së sotme, por edhe më gjërë ka banuar fisi ilir i **Pirustëve**. Ky fis përmendet deri nga shekulli i parë i erës së re. Pirustët u morën me bujqësi e blegtori, por në mënyrë të veçantë u shquan si punëtorë të zellshëm për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit e të hekurit.

Më vonë krahina e Mirditës përfshihet në Principatën e Arbërit, që përmendet si shteti i parë mesjetar (1190-1216), që shtrihet nga lumi Drin në Veri e deri në lumin Shkumbin në Jug. Ndërfandina (pjesa më e madhe e së cilës përfshihet në njësinë administrative të Bashkisë Rrëshen) konsiderohej një nga qendrat e rëndësishme të kësaj Principatë. Një gjë të tillë e dëshmojnë Stema e Arbërit dhe mbishkrimet në gurët e gjetur në Kishën e Shën Mërisë në fshatin Gëziq. Sipas Shuflait, Mirdita del si krahinë me emrin e vet në fund të shekullit XVI, kurse vetë emri Mirditë njihet më herët, si njësi etnografike.

Historia e Bashkisë Rrëshen formohet hap pas hapi me hapjen e shkollës së parë shqipe 1906 në Kodër Rrëshen, të shkollës së parë 7 vjeçare në Rrëshen më 1947, të konviktit të kësaj shkolle më 1952, të shkollës së parë të mesme më 1960, e cila kishte 21 nxënës nga të cilat 2 vajza, të Pallatit të Kulturës, të Kinemasë së qytetit, të Spitalit të qytetit, të Muzeut Historik të Rrethit të Mirditës, të Stadiumit të futbollit, të Pallatit të Sportit òArjana Arapiò, katëdralja e Rrëshenit, qendra profesionale òShën Jozefi Punëtorò.

IV.KLIMA

Nga pikëpamja klimaterike Bashkia Rrëshen shtrihet në zonën mesdhetare-kodrinore me dimër të butë dhe të lagësht, verë të nxehtë dhe të thatë. Nga pikëpamja e temperaturave, për shkak të ndikimit të elementëve të relievit, në periferi vihen re amplituda relativisht të mëdha midis dimrit dhe verës.

Numri i ditëve me reshje luhatët nga 120 ó 125 ditë, me një mesatare vjetore 1800 mm. Muajt me reshje më të shumta janë Dhjetori, Janari, Shkurti me një sasi që luhatët nga 191 mm deri në 162 mm. Bora në zonat e larta mbi 1000m shkon në trashësi mesatare 30-150 cm. Në gropën e Rrëshenit mesatarja shumëvjeçare e rreshjeve është e lartë, pra më e lartë sesa mesatarja shumëvjeçare e rrethit dhe shumë më e lartë sesa mesatarja shumëvjeçare e Shqipërisë. Temperatura mesatare vjetore 13.3°C duke u luhatur nga 4.4°C në muajin janar në 24.5°C në korrik. Maksimumi absolut i temperaturës në qytetin e Rrëshenit 40.5°C dhe minimumi absolut -14°C. Amplituda mesatare vjetore 18.1°C.

Periudha e vegjetacionit fillon në fillim të Prillit dhe përfundon në muajin Tetor duke zgjatur rreth 210 ditë.

Nr	Emërtimi	Njësia	Stinët				Vjetore
			Pranverë	Verë	Vjeshtë	Dimër	
1	Temperatura mesatare	°C	10	22	14	2	13.3
2	Lagështia relative	%	52	48	52	60	
3	Rreshjet	mm	330	170	510	500	1510
4	Djellëzimi	Orë					2500

Burimi: Stacioni meteorologjik Rrëshen.

V.Burimet natyrore

Ndërtimi Gjeologjik

Rrethi i Mirditës shtrihet i gjithi në zonën magmatike òMIRDITAò.Përbërja gjeologjike e territorit të Mirditës është përgjithësisht magmatike-efuzive (ultrabazikë, bazikë, terrigjenë etj) por në Veri, Verilindje dhe Jugperëndim shtrihen pllaja dhe kurrize malore sedimentare karbonatike.

Relievi

Rrethi i Mirditës nga pikëpamja morfologjike (pamja fizike) është territor malor. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 557 m. Kjo lartësi në pamje të parë duket si kodrinore, por dendësia e

copëtimet horizontal 7-8 km/km² e justifikon këtë lartësi. Lartësia mbi 80 m mbi nivelin e detit e deri në 2121m (Maja e Kunorës) janë treguesit e kontrasteve shumë të mëdha të relievit.

Gropa e Ndërfanës (Rrëshenit) është gropë me origjinë liqenore ku në të shtrihet pjesa më e madhe e territorit të Bashkisë. Kjo gropë ka një lartësi mesatare 150-200 m mbi nivelin e detit. Territori i saj në përgjithësi është i çrregullt për shkak të ndërtimit gjeologjik dhe ndikimit të hidrografisë, e cila ka bërë një prishje të uniformitetit të gropës ku veçohen një numër i madh kodrinash.

Territori i Bashkisë Rrëshen në periferinë e tij ka maja si ajo e Dervenit 817m dhe e Livadhësit 786 m mbi nivelin e detit.

Hidrografia

Mirdita përshkohët nga 4 arterie relativisht të mëdha lumore si Fani i Bashkuar, Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka, të gjitha këto degë të lumit Mat.

Fani i Madh ka një gjatësi 60 km dhe një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 415 km² me një pjerrësi të shtratis 23m/km, me një prurje mesatare prej 15.5 m³/sek.

Në territorin e Bashkisë së Rrëshenit kalon Fani i Vogël dhe Fani i Madh, Zmeja e Madhe dhe Zmeja e Vogël, degë të së parës, qe bashkë me një numër të madh përrrenjsh furnizojnë me ujë këtë të fundit. Gjatësia e Zmesë së Madhe është 18 km, ndërsa e Zmesë së Vogël 12 km. Fani i Madh dhe Fani i Vogël, mund të lundrohen me kajak. Në territorin e Bashkisë ndodhen pesë rezervuarë me kapacitet ujëmbajtës rreth 4.2 milion m³ ujë të cilët kanë një aftësi ujëtare rreth 800 ha.

VI. Demografia

N	Emertimi	Banore							Familje						
		2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
A	Qyteti i Rrëshenit	8409	8418	8122	8021	7954	7912	8034	2207	2243	2046	1996	2071	2080	2092
B	Fshatrat	6845	6827	6743	6694	6295	6298	6291	1738	1726	1695	1682	1610	1618	1608
1	Ndërfusha	560	553	548	549	517	521	517	143	137	133	133	133	137	133
2	Ndërfanë	527	526	539	542	532	531	527	139	139	138	138	137	137	137
3	Gëziq	546	542	538	533	500	497	500	143	147	147	147	149	161	159
4	Tarazh	944	944	934	934	882	888	899	222	220	212	209	195	193	193
5	Jezull	394	403	403	390	378	376	365	99	99	100	100	98	97	94
6	Bungaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Kodër Rrëshen	651	654	654	653	640	644	650	164	164	163	161	155	154	154
8	Sheshaj	482	363	345	352	326	327	322	116	87	84	84	78	78	79
9	Fushë-Lumth	596	591	582	581	562	563	559	169	167	166	165	161	161	160
10	Malaj	626	620	622	617	548	535	524	163	161	162	154	140	139	137
11	Malaj i Epërm	287	288	273	265	236	243	236	73	72	68	64	55	54	51
12	Tenë	357	351	351	332	297	291	297	82	79	70	79	75	73	73

13	Kulme (2000)	0	130	125	122	109	114	117	0	28	28	27	27	27	30
14	Lurth	301	298	282	275	263	261	263	80	82	82	79	76	76	75
15	Bukmirë	574	564	547	549	505	507	515	145	144	142	142	131	131	133

Numri i banorëve dhe familjeve në Bashkinë e Rrëshenit

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile- Bashkia Rrëshen.

XI.Shërbimet publike

Shërbimi Telefonik

Shërbimi telefonik ofrohet me central digjital me dalje automatike nderkombetare me kapacitet të mjaftueshem dhe mundesi rritjeje sipas nevojave. Shtrirja e ketij rrjeti është për qendren (Rrëshenin) dhe fshatrat përreth tij. Funksionojnë disa lloje shërbimesh, në mes tyre dhe ai i internetit,ADSL.

Perveç shërbimit celular AMC dhe Vodafon është vendosur edhe operatori i trete Eagle Mobile, dhe po montohet operatori i katert që mbulon të gjithë territorin e Bashkise.Rrjeti telefonik i qytetit është në standarte të larta teknike dhe në vazhdimesi i paraprihet furnizimit me shërbim telefonik për ndertimet e reja dhe rritjen e zgjerimit të qytetit.

Krahas shërbimit të telefonise fikse e celulare funksionon edhe shërbimi me kartofona për qytetin.

Shërbimi i Furnizimit me Energji Elektrike

Rrethi i Mirditës furnizohet me energji elektrike nga H-C i Ulzës dhe i Fierzës nëpërmjet 5 nënstacioneve elektrike: Rubik 110/35/6kv, Rrëshen 35/10kv, Kurbnesh 35/10kv, Repts 110/6kv, Kaçinar 35/10kv.

Shpërndarja e energjisë elektrike administrohet nga Filiali Elektrik Mirditë që bën pjesë në KESH. Ndryçimi rrugor administrohet e mirembahet nga Bashkia e Rrëshenit.

Çmimet e energjisë elektrike ne lek per kv/ore pa tvsh

Perdoruesit	Tensioni mesem	Tensioni i larte
Tregeti e sherbime	7,5	10
Bujqesi e industri	7,5	8
Furre buke e prodhimi	7	7,5
Per buxhetore	9,5	12
Jo buxhetore	8	10

Për mjedise të përbashkëta si shkallë, pompa, ashensorë me 7 lekë për kv/orë.Ndërsa për familjet deri në 300 kv/orë çmimi është 7 lekë për kv/orë dhe mbi 300 kv/ore është 12 lekë për kv/orë.

Burimi i informacionit: Axhensia Elektrike Mirditë,OSSH

Furnizimi me Ujë të Pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm realizohet nga Sh.A. oUjësjetllës Kanalizimeveo Mirditë, ku aksionerë janë tri njësi vendore, bashkia Rrëshen, komuna Selitë dhe komuna Orosh.

Prodhimi i sotëm për qytetin dhe rrethinat e Rrëshenit realizohet nëpërmjet stacionit të pompimit me fuqi të instaluar 220 kw përmes dy linjave paralele me dy puse dhe me prurje në depo 60 litra/sek. Kapaciteti ujëmbajtës i depove është 1000 m³ ujë, dhe një depo e re shton dhe 500 m³ ujë në pjesën më të lartë të qytetit.. Tani për tani qyteti furnizohet me 13,5 orë, Sistemi i kanaleve të ujëravë të zeza të qytetit është funksional dhe i ndarë nga sistemi i ujëravë të bardha.

Tarifat e ujit të pijshëm

Nr	Lloji i konsumatorit	Pagesa
1	Konsumatorët familjarë	45 lekë/m ³ .
2	Buxhetorët	80 lekë/m ³ .
3	Privatët	100 lekë/m ³ .

Burimi: SH.a. Ujësjetllësi Mirditë.

Inventari i sistemeve të rrugëve dhe kanalizimeve.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	
1	Inventari I rrugëve	Rrugë të asfaltuara	km	5.7
		Rrugë të pa asfaltuara	km	1.2
		Sheshe publike	m ²	4104
2	Trotuaret	Trotuare me pllaka	m ²	7050
3	Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza	Kanale Ø 200	ml	2600
		Kanale Ø 300	ml	1400
		Kanale Ø 500	ml	1300

Burimi: Bashkia dhe Dega e Tatim Takasave.

Shërbimi i Pastrimit

Shërbimi i i Pastrimit të qytetit kryhet me sipërmarrje. Vlefata vjetore e kontrates është **6 278 872 lek**

Nr	Proçeset e Punes	Njesia	Volumi	Çmimi njesi	Vlefata lek
1	Fshirje rruge,trotuare	M2	44 470/dite	0.184	2 994 860
2	Transp.mbetur.urbane	Ton /vit	4 380	474.5	2 078 385
3	Larje rruge në qytet	M2	15 000/dite	23	346 011
4	Dezinfektim kontinieresh	Pika	40	9 887	395 490
5	Mirembajtje WC publike	cope	1	-	399 126
6	Edukim publik	Ne/vit	-	-	65 000
	TOTALI				6 278 872

Shërbimi i gjelbërimit

Qyteti i Rrëshenit ka përmirësime të dukshme në shërbimin e gjelbërimit nga viti në vit. Aktualisht ndodhen 19.026 m² sipërfaqe të gjelbëruara ose 2,378 m² për 1 banor nga 1,87 që ishte për vitin 2007. Synohet që për vitin 2011 të arrihet në një sipërfaqe prej 24.000 m² ose 3 m² për banor sipërfaqe të gjelbëruar. Në tërë sistemin gjelbërues të qytetit Rrëshen, listohen 56 lulishte, 2248 ml gardh ligustër, 1468 pemë dhe shkurre dekorative me gjelbërim të përhershëm dhe gjetherënëse. **Sipërfaqe lulishte: 2500 m², Sipërfaqe me bar të kultivuar: 19000 m², Bordure të gjelbëruara: 2312 m².**

ARSIMI

Institucionet arsimore në bashkinë Rrëshen përfshijnë gjithësej 11 shkolla publike 9 vjeçare dhe 1 shkollë publike e mesme si dhe 1 qendër profesionale. Në shkollat 9 vjeçare mësojnë 1578 nxënës dhe në shkollën e mesme 813 nxënës si dhe 122 nxënës në qendrën profesionale. Ka dhe 9 kopshte me 308 fëmijë dhe 26 edukatorë. Ndersa Zyra Arsimore e Rrethit ndikon në ecurinë e këtij sektori dhe cilësinë e mesimdhënis, pushteti vendor është përgjegjës për mirembajtjen e objekteve arsimore.

Ka vetëm 1 cerdhe në qytet me rreth 50 fëmijë dhe 9 edukatorë që u shërbejnë.

Problemi mbetet përqëndrimi i mjediseve arsimore në qytetin e Rrëshenit, ku dhe tendencat e banorëve të zonave është për t'u dërguar fëmijët e tyre për shkollim në këtë qytet.

TE DHENAT STATISTIKORE PËR SHKOLLAT VITI 2007-2010

Nr	Emertimi	Bashkia
		Rreshen
1	Numri i nxenesve gjithsej	2391
a	Numri i nxenesve në shkolle 9-vjeçare	1578
b	numri i nxenesve në shkollat e mesme	813

2	Numri i shkollave publike	11
a	Shkolla 9-vjeçare	10
b	Shkolla të mesme	1
3	Mesues që punojnë gjithsej	158
a	Mesuesit që punojnë në arsimin 9-vjeçar	116
b	Mesuesit që punojnë në arsimin e mesem të përgjithshëm	42
c	Mesues me arsim profesional	
5	Raporti mesues nxenes	15.13
6	Paga mesatare e mesuesve(leke)	39995
7	Numri vjetor i deftesave të pjekurise	171
a	Nxenes pa shkeputje nga puna	----
b	Nxenes me shkeputje nga puna	171
8	Te drejtat e studimit për shkollat e mesme jashte rrethit	26
9	Te drejtat e studimit për shkollat e larta	51
10	Te drejtat e studimit jashte shtetit	3
11	Nxenes në shkollat profesionale	122
12	Numri i femijve në kopshte	308
13	Numri i kopshteve	9
14	Numri i edukatoreve në kopshte	26

Shëndetësi

Drejtoria e Shërbimit Publik në Mirditë ka në përbërje katër shërbime kryesore: Shërbimi spitalor, shërbimi i higjienës dhe Epidemiologjisë, shërbimi ambulator dhe shërbimi i poliklinikës.

Në qytetin e Rrëshenit funksionon dhe një spital vendor me shërbimet bazë ndaj komunitetit jo vetëm të kësaj bashkie por të tërë Mirditës.

Shërbimi spitalor është i organizuar në pesë reparte: urgjenca, pathologjia, kirurgjia, obstetrik-gjinekologjiku dhe reparti i pediatriisë.

Vlen te përmendim partneritete me shoqata humanitare dhe spitale të tjera të komunitetit europian për përmirësimin e teknologjisë dhe shërbimin diagnostikues dhe shërues. Karitasi italian òAvelino për Il Mondoò ka kontribuar për sjelljen e aparaturave, kualifikimeve në Itali të personelit dhe kanë zbatuar disa projekte të rëndësishme për grata që lidhen me analizën e paptestit dhe vaksinimin kundër kancerit të qafës së mitrës,etj.

Të dhëna për Spitalin e Rrëshenit.

Nr	Repart	Nr. shtretërve	Mjekë	Personel i Mesëm	Personel Shëndetësor
1	Pathologji	26	3	12	21
2	Matërniteti	25	2	12	20
3	Kirurgji	19	1	12	18
4	Pediatri	26	1	11	19
5	Urgjenca	4	1	10	17
6	Reanimacioni		1	4	7
7	Poliklinika		4	17	23
8	Administrata		1	3	4
9	Radiologjia		-	2	3
10	Laboratori		1	7	12

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik- Rrëshen.

Transporti

Rrjeti i brendshëm i rrugëve të qytetit

Pozicioni gjeografik i Qytetit të Rrëshenit, kushtëzon lidhjen tokësore si me Kryeqytetin ashtu edhe me qytetet fqinjë. Qyteti ka 5.3 km rrugë të brendëshme me një sipërfaqe 15,000 m².

Lidhja me kryeqytetin bëhet nëpërmjet rrjetit rrugor nacional. Rrjeti i rrugëve nacionale brenda rrethit është 113 km, ndërsa i rrugëve rurale është 207 km.

Rrethi i Mirditës dhe Qyteti i Rrëshenit janë pika nyje nëpër të cilat kalon autostrada Durrës-Prishtinë.

Distancat e Fshatrave të Bashkisë nga qendra e Bashkisë Rrëshen.

Nr	Fshati	Km	Nr	Fshati	Km
1	Gëziq	12	9	Sheshaj	6
2	Tenë	18	10	Kulma	7
3	Malaj i Epërm	18	11	Lurth	10
4	Malaj Qender	15	12	Bungaj	6
5	Fushë Lumth	1	13	Bukmirë	13
6	Kodër Rrëshen	5	14	Ndërfushas	5
7	Jezull	3	15	Ndërfanë	5
8	Tarazh	5			

Burimi: Bashkia Rrëshen.

Të dhëna mbi llojin dhe numrin e automjeteve në bashkinë e Rrëshenit.

Nr	Emërtimi	Viti 2011 (copë)
1	Autovetura	1 860
2	Furgonë+kamion deri 3 ton	339
3	Autobuzë	22
4	Kamionë mbi 3 ton	133
5	Shuma	2354

XIII.Cilësia e jetës dhe prognoza e zhvillimit urban

Duke analizuar ecurinë përgjatë këtyre viteve të tranzicionit, deduktohet se qyteti i Rrëshenit dhe i tërë pellgu që përfshin kjo bashki, është i jetueshëm optimalisht, ndaj dhe ka patur gjithnjë balancim numerik të popullatës së migruar apo të emigruar me atë të ardhur për të mbetur në shifrat e 8 mijë banorëve me tendencë rritjen e mëtejshme. Fakti është se në qytet as dhe një hyrje apartament nuk është e abandonuar, po ashtu banesat në fshatrat e bashkisë. Ka tendencë për ndërtime të reja si në qytet dhe fshat.

Nëse për 10 vite nuk kishte asnjë ndërtim banesë për strehim nga enti shtetëror në qytetin e Rrëshenit, keto vitet e fundit kanë përfunduar disa pallate të reja 9 dhe 11 katëshe, dhe është një tjetër në proces, ndërkohë që ka disa kërkesa të tjera për ndërtime të larta me shumë apartamente. Në zonën përreth qytetit janë krijuar lagje të tëra me ndërtime të reja tip vilash 2 e 3 kate. Mozaiku ndërtues i qytetit përbëhet nga pallatë të tipit të para 90-s me tulla dhe parafabrikatë, çka bën të nevojshëm ndërhyrjen në fasadat e eroduar, por dhe pallatë të reja e vila të ndryshme, ashtu si dhe një sërë ndërtime biznesi, apo qendra kulturore, administrative e sociale.

Por në prognozimin urbanistik të qytetit Rrëshen po punohet me asistimin e APRODEL (organizatë spanjolle) për të sjellë një realitet modern në këtë aspekt. Kështu janë ngritur disa komisione pune për definimin e variantit më të përshtatshëm, më me perspektivë; ndarja në zona tregtare, zona rezidenciale (me ndërtime shumkatëshe), zona industriale, zona e ndërtesave private (tip vile), zona e gjelbërt etj, harmonizimi arkitekturor dhe funksional i elementëve përbërës, mundësitë e mbështetjes buxhetore, gjetja e donatorëve, disiplinimi i ndërtimive, rikonstruksioni i banesave të vjetra, duke ruajtur traditën dhe arkitekturën ekzistuese etj. Po ashtu për shfrytëzimin dhe disiplinimin e lumenjëve Fan i vogël, Fan i Madh, Zmesë, apo të përrënjeve të Kulmes dhe Jakajve, duke krijuar mjedise ujore përmirësuese të klimatis të qytetit. Zbatimi i planit urbanistik, menaxhimi i tij mbështetet mbi buxhetin e bashkisë, subvencionimin si dhe donatorët e investuesit privat.

Institucionet kryesore në varesi të bashkisë

Pallati i Kulturës "Mirdita":

Pallati i kulturës Kulturës u përrua në vitin 1970 dhe ka një sallë milenium me një kapacitet prej 400 vendesh. Arkitektura e tij është e tipit modern e harmonizuar me ndërtesa përreth dhe sheshin e qytetit. Ka të përmendur ansamblin folklorik tipologjik të Mirditës si dhe bart tradita të hershme në pasurinë kulturore dhe atë shpirtërore.

Në skenën e Shtëpisë së Kulturës ka ushtruar aktivitetin e tij ansambli folkloriko-kulturor "Mirdita" i përmendur si një ndër më të mirët në shkallë kombëtare.

Biblioteka "Gjon Gazulli"

Në mjediset e pallatit të Kulturës është instaluar Biblioteka e Qytetit të Gjon Gazullit me afro 70.000 ekzemplarë dhe një numër të konsiderueshëm titujsh për t'u admiruar. Vlejnë për tu theksuar botimet e autorëve mirditorë me afro 100 tituj për këto vite si studime, antologji, romane, libra me poezi, monografi etj.

Në një mjedis tjetër ushtron aktivitetin e saj edhe **Qendra Kulturore e Fëmijëve me varësi nga zyra arsimore**, me një grup të njohur si pasardhës i denjë i asanblit, vlerësuar me cmime të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Muzeu Historik.

Muzeu u ndërtua në vitin 1974 dhe evokon historinë shumëshekullore të Mirditës. Në të janë ekspozuar vlerat historike qysh prej paraardhësve të mirditasve, fisi i dëgjuar i përpunimit të bakrit "Pirustët", e deri në ditët e sotme.

Vlerat ekspozuese të tij shtohen veçanërisht pasi në të gjendet përmendorja e Arbërit, treguesi kuptimplotë i vazhdimësisë Iliro-Shqiptare. Vlerave historike të tij i shtohen edhe me vlerat dhe ekspozatën etnografike të evidentuara në të.

Kinemaja:

Kinemaja u ndërtua në vitin 1972 dhe ka një kapacitet prej 120 vendesh. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në edukimin qytetar nëpërmjet filmit dhe tani është hapur një qendër rinore me internet, lojra dhe kurse të ndryshme kompiutri, gjuhesh të huaja etj.

Rikonstruksioni i saj në vitin 2001 e ka kthyer atë ndër kinematë me cilësoret të këtij lloji në Shqipëri.

Pallati i Sportit "Arjana Arapi"

Pallati u ndërtua në vitin 1985, me kapacitet 800 vende. Në të ushtron aktivitetin e tij ekipi i volejbollit "Minatori", pjesëmarrës në kategorinë e parë për femra.

Ky ekip është formuar në vitin 1976 dhe deri më sot ka përfaqësuar me dinjitet femrën mirditore.

Stadiumi i Futbollit.

Stadiumi u ndërtua në vitin 1987, ka një kapacitet prej 1500 vendesh dhe ka përmasa olimpike. Në të zhvillon aktivitetin ekipi i futbollit të të rriturve "Minatori" pjesëmarrës në kategorinë e dytë.

Stadiumi është i pajisur me anekse për zhvillimin e stërvitjeve të ekipeve zinxhirë.

Institucione që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë Rreshen

Institucionet Fetare

Në Rrëshen ndodhet qendra e Dioqezës e cila përfshin Rrethet e Mirditës, Matit, Bulqizës dhe Peshkopisë. Në këtë dioqeze veprojnë misionarë Vinçensian, franceskianë, për çështje të edukimit me paqen etj. Gjenden 15 kisha në Rrethin e Mirditës. Në Bashkinë e Rrëshenit ndodhen: Kisha Katolike, Katëdralja Katolike dhe Qendra profesionale.

Bankat

Në bashkinë e Rrëshenit ushtrojnë aktivitetin tre filiale bankash të rëndësishme të cilat me aktivitetin dhe konkurrencën mes tyre, kanë ofruar shërbime të rëndësishme për klientët. Të tre këto banka ofrojnë të gjitha shërbimet e bankave serioze, si në hapjen e numrave të llogarisë, kredihënje, depozita, këmbim valute etj. Këto banka me mbështjen e tyre financiare i kanë dhënë një hov të rëndësishëm


ekonomisë dhe biznesit ndërkohë që kanë krijuar një partneritet dhe besueshmëri. Tre bankat që operojnë në Rrëshen janë : Raiffeisen Bank, Banka Popullore dhe BKT

Fondi i Finacimit të Zonave Malore (institucion financiar jobankar)

Fillon veprimtarinë e haudhënies në korrik të vitit 2000. Privatizmi dhe transformimi në bankë rurale u be në shkurt 2005. Donatorët e këtij Fondi janë qeveria shqiptare, IFAD, OFID dhe kooperacioni italian FFAM. Operon me 20 degë dhe që mbulojnë 24 rrethe, 850 fshatra dhe në rrethin tonë ka finacuar më shumë se 200 kreditime për fermerë dhe biznese. Fushat e kreditimit bujqësi, blegtori, tregti, shërbnime, artizanat.

WORD Vision

Ofron kredi të vogla për të ulur nivelin e varfërisë në zonat rurale, për familjet më pak të shërbyera. Kreditë oforohen në sektorët bujqësi, blegtori, ndërtim, makineri e pajisje, kapital qarkullues dhe kredi konsumatore.



1. Ligji nr. 8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave"
2. Ligji nr.8934 datë 05.09.200 2"Për mbrojtjen e mjedisit"
i ndryshuar me
Ligjin nr.9890 datë 20.03.0208
Ligji nr.9983 datë 08.09.2008
Ligji nr.10 137 datë 11.05.2009

3. Ligji nr.9010 datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve urbane"
i ndryshuar me ligji nr.10 137 datë 11.05.2009
4. Ligji nr.8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"
i ndryshuar me
Ligjin nr.9352 datë 03.03.2005
Ligjin nr.9584 datë 17.07.2006
Ligjin nr.9915 datë 12.05.2008
5. Ligjin nr.9537 datë 18.05.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme"

ndryshuar me
Ligjin nr.10 137 datë 11.05.2009
6. Ligji nr.8990 datë 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
Ndryshuar me ligji nr.98990 datë 220.03.2008
Ligjin nr.001 050 datë 24.12.2008
7. Ligji nr.9115 datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
8. Ligji nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
i ndryshuar me ligjin nr. 10 266 datë 15.04.2010
9. Ligji nr.9379 datë 28.04.2005 "Për efikasitetin e energjisë"
10. Ligji nr.9424 datë 06.10.2005 "Për ratifikimin e Protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor"
11. Ligji nr.9587 datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
12. Ligji nr. 8906 datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura" ndryshuar me
Ligjin nr.9868 datë 04.02.2008
13. Ligji nr.8093 datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore" ndryshuar me
Ligjin nr. 8375 datë 15.07.1998
Ligjin nr.8605 datë 20.04.2000
Ligjin nr.8736 datë 01.02.2001
Ligjin nr.9837 datë 03.12.2007
Ligjin nr.10 137 datë 11.05.2009
14. Ligji nr.10 081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

VKM

1. VKM nr. 99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"
2. VKM nr.177 datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"
3. VKM nr. 289 datë 15.04.2005 "Për përcaktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, të autorizimeve dhe të koncensioneve për përdorimin e ujit.
4. VKM nr. 835 datë 28.11.2005 "Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen me qëllim ruajtjeve, depozitimin dhe asgjësimin"

5. VKM nr. 805 datë 04.12.2003 "Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis për të cilat kërkohet leje mjedisore"
6. VKM nr. 806 datë 04.12.2003 "Për miratimin e rregullave të procedurave për importimin e mbetjeve, për përdorim, përpunim dhe riciklim"
7. VKM nr.395 datë 21.06.2006 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor"
8. VKM nr. 435 datë 12.09.2002 "Për miratimin e normave, të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
9. VKM nr. 469 datë 23.06.2005 "Për miratimin e strategjisë dhe të planit kombëtar të veprimit për zbatimin e konventës së Aarhusit"
10. VKM nr. 847 datë 29.11.2007 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit"
11. VKM nr. 267 datë 24.04.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike"
12. VKM nr. 994 datë 02.07.2008 "Për tëheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin"
13. VKM nr. 1124 datë 30.07.2008 "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor"
14. VKM nr. 1553 datë 12.11.2008 "Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të përcaktuara të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit, të angazhimeve të protokollit të Kiotos"
15. VKM nr.508 datë 13.05.2008 "Për miratimin e raportit për gjendjen e mjedisit në vitin 2008"
16. VKM nr. 825 datë 3.10.2010 "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi"
17. VKM nr. 798 datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore"
18. Udhëzim nr. 6 datë 27.12.2006 "Për miratimin e teodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie"
19. Udhëzim nr. 6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shaktuese nga mjetet rrugore" i ndryshuar me Udhëzimin nr.MPPT dhe MMPAU nr.12 datë 15.06.2010.
20. Udhëzim nr.5 datë 28.12.2007 "Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore"
21. Udhëzim nr.6 datë 27.11.2007 "Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administratës të mbetjeve të ngurta"
22. Udhëzim nr.1 datë 07.01.2008 `
23. Rregullore higjeno-sanitare datë 17.11.1997 "Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave"
24. Rregullore nr.1 datë 30.03.2007 "Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre"

Vendimi I keshillit të bashkise Rreshen nr. 43 dt 17.10.2008 per Planin Strategjik të Zhvillimit Ekonomik të Bashkise Rreshen

Vendimi I Keshillit te Bashkise Rreshen nr. 11 dt. 16.02.2009 per Miratimin e
Vendgrumbullimin dhe Trajtimit te Mbetjeve Urbane

Pergatiti: Dod PEPKOLAJ

BASHKIA RRESHEN